



VENDIM

Nr. 27, Datë 09.03.2016

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI
ELEKTRIKE MIDIS KESH SH.A/FPSH DHE OSHEE SH.A/FPP**

Në mbështetje të nenit 16, 20 gërma “h”, 108, 110 të Ligjit nr. 43/2015, Për Sektorin e Energjisë Elektrike; pikat 4; 14 gërma “A” pika 2 dhe pika 7, gërma “f” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008, i Këshillit të Ministrave, Kapitulli V i Rregullave të Tregut Shqiptar miratuar me vendimit nr. 68, datë 23.06.2008 të ERE, i ndryshuar dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 09.03.2016, pasi u njoh kërkesën e shoqërisë KESH sh.a për miratimin e “Marrëveshjes për Furnizimin me energji Elektrike midis KESH sh.a/FPSH dhe OSHEE sh.a/FPP për periudhën 1 Janar 2016 – 30 Qershor 2016, si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE,

Konstatoi se :

- KESH sh.a është e licensuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 10 datë 06.02.2014.
- OSHEE sh.a është e licensuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97 datë 27.10.2014.
- KESH sh.a dhe OSHEE sh.a kanë lidhur në datë 31.12.2014, Marrëveshjen “Për Furnizimin me Energji Elektrike nëpërmjet FPSH/KESH sh.a. dhe FPP/OSHEE sh.a., me afat 1 (një) vjeçar, miratuar me vendimin e ERE nr. 11 datë 04.02.2015;
- Palët kanë nënshkruar bashkërisht këtë marrëveshje e cila i shtrin efektet nga data 1 Janar 2016 deri më datë 30 Qershor 2016.

- Me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", hidhen bazat për krijimin e një modeli të ri të tregut të energjisë elektrike dhe marrëdhënieve që do të vendosen midis pjesëmarrësve në këtë treg dhe në sektorin elektroenergjitik. Ky ligj parashikon një sërë aktesh nënligjore dhe rregullatore që duhet të miratohen (përcaktim i nenit 108) brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi, për të siguruar zbatimin e plotë të tij; Po ashtu në kuptim të nenit 109 pika 5, detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut do të vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji.
- Baza ligjore e përdorur nga palët për nënshkrimin e kësaj marrëveshje është e pasaktë:
 - a. Vendimi nr. 68, datë 23.06.2008 i Bordit të Komisionerëve të ERE "Për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar", më të gjitha ndryshimet e tij është baza ligjore e saktë që duhet të përdoret. Si rrjedhojë vendimi nr. 10, datë 27.01.2016 "Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015 "Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike" nuk duhet të citohet në mënyrë të veçantë.
 - b. vendimi i pasqyruar me nr. 58, datë 03.06.2008 i Bordit të Komisionerëve të ERE duhet të jetë vendimin nr .97 date 27.10.2014, "Për licensimin e shoqërisë operatori i shpërndarjes te energjisë elektrike sh.a ne aktivitetin e furnizuesit publik me pakice te energjisë elektrike".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Marrëveshjes "Për Furnizimin me Energji Elektrike ndërmjet FPSH/KESH sh.a dhe FPP/OSHEE sh.a, për periudhën 01.01.2016 deri në datë 30.06.2016, me ndryshimet përkatëse në bazën ligjore në përmbajtje të marrëveshjes si me poshte:
 - a. vendimi nr. 10, datë 27.01.2016 "Për një ndryshim në vendimin nr. 157, datë 28.12.2015 "Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike" duhet të zëvendësohet me Vendimi nr. 68, datë 23.06.2008 i Bordit të Komisionerëve të ERE "Për miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar", i ndryshuar
 - b. vendimi nr. 58, datë 03.06.2008 i Bordit të Komisionerëve të ERE duhet zëvendësohet me vendimin nr .97 date 27.10.2014, të Bordit të Komisionerëve të ERE "Për licensimin e shoqërisë Operatori i shpërndarjes te energjisë elektrike sh.a ne aktivitetin e furnizuesit publik me pakice te energjisë elektrike".

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2016 -30 Qershor 2016

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.